

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

për ofrimin e shërbimeve laboratorike
Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet ndërmjet:

Laboratori EXACT SH.P.K
Perfaqesuesi: Lirim Hyseni
Adresa: Rr.Hasan Prishtina, 194, Obiliq, Kosovë
(në vazhdim " Laboratori"

Sindikata e Policise
Perfaqesuesi: Avdi Hoti
Adresa:Luan Haradinaj, Prishtine
(në vazhdim " Partneri"

Neni 1 – Qëllimi i bashkëpunimit

Qellimi i kësaj marrëveshje është krijimi i një bashkëpunimi profesional ndërmjet palëve për ofrimin e shërbimeve laboratorike për pacientët e Partnerit, me kushte preferenciale, zbritje dhe mbështetje profesionale.

Neni 2 – Shërbimet laboratorike.

Laboratori do të ofrojë analiza laboratorike duke përfshirë:

*Analizat Hematologjike , Biokimike, Imunologjike Autoimmune, Alergjike ,Endokrinologjike, Prenatale & Postnatale, Tumormarkerë,Serologjike,Analizat e Vitaminave,Elektrolitet dhe mineralet, Analizat urinare, Proteineve Specifik etj...

* Dhe analiza të tjera rutinë apo me specifike sipas kërkesave në bashkëpunim me partneret tanë vendore dhe ndërkombëtare.

Rezultatet mund të dorëzohen :

Fizikisht

Online

Apo përmes platformave të komunikimit sipas marrëveshjes.

Neni 3 – Perfitimet e partnerit

20% zbritje në shumicën e analizave laboratorike për pacientët e referuar, si dhe për familjarët e ngushtë: nëna, babai, fëmijët, bashkëshortja/bashkëshorti, vëllai dhe motra.

10% zbritje për analizat specifike dhe të avancuara që dërgohen jashtë laboratorit tonë për përpunim, përfshirë analiza mikrobiologjike, PCR dhe analiza të specializuara të realizuara në laboratorë partnerë ndërkombëtarë në Gjermani dhe Turqi.

* çmime preferenciale për analiza dhe paketa laboratorike

* rezultate prioritare dhe procesim më të shpejtë të mostrave

* rezultate STAT për raste urgjente

* përgjigje më të shpejta për raste urgjente dhe prioritare

* kontakt dhe komunikim të drejtpërdrejtë me laboratorin

* mbështetje profesionale dhe bashkëpunim të vazhdueshëm

Neni 4 – Oferta sezonale dhe promovionale

EXACT LAB do të organizojë oferta promovionale sezonale për partnerët dhe pacientët e referuar, duke përfshirë:

* paketa check-up

* paketa tiroide

* paketa hormonale

* paketa për diabet

* paketa për shtatzëni

* oferta promovionale sipas sezonit dhe fushatave shëndetësore

Neni 5 – Obligimet e Laboratorit

Laboratori obligohet të:

- * garantojë cilësi dhe saktësi të analizave
- * respektojë afatet e rezultateve
- * ruajë konfidencialitetin e të dhënave
- * ofrojë mbështetje profesionale për partnerin
- * sigurojë trajtim prioritar për rastet urgjente

Neni 6 – Obligimet e partnerit

Partneri obligohet të:

- * referojë pacientët në laborator sipas marrëveshjes
- * respektojë kushtet profesionale të bashkëpunimit
- * përdorë informacionet dhe rezultatet vetëm për qëllime profesionale

Neni 7 – Pagesat

Pagesa për analizat laboratorike do të realizohet direkt nga pacienti në laborator në momentin e pranimit të shërbimit. Partneri nuk ka obligime financiare ndaj laboratorit për shërbimet e kryera për pacientët e referuar.

Neni 8 – Kohëzgjatja e marrëveshjes

Kjo marrëveshje hyn në fuqi nga data 02/06/2026 dhe mbetet valide deri në ndërprerjen e saj nga njëra palë me njoftim paraprak prej 30 ditësh.

Neni 9 – Konfidencialiteti


Të dy palët obligohen të ruajnë konfidencialitetin e të gjitha informacioneve profesionale dhe të dhënave të pacientëve.

Nenshkrimet :

Laboratori EXACT SH.P.K

Sindikata E Policise

Nenshkrimi:


EXACT LAB
Obiliq

Nenshkrimi:

